




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 2020
Nr. 30.11.2021

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim të BPrAL i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave të nenit 11 paragrafi 3 dhe 4, nenit 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 si dhe në bazë të neneve 5, 6, 7, 8 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, si dhe në bazë të vendimit nr.2-3006 i datës 11.11.2021 i nxjerrë nga zv. sekretari i MASHTI për Rishqyrtim të lëndës së BPrAL- kolegji “Pjetër Budi” nxjerr këtë :

V E N D I M

1. Bartësit Privat i Arsimit të Lartë (BPrAL)- kolegjit “Pjetër Budi”, në Prishtinë, i refuzohet kërkesa për Licencim.
2. I ndalohet regjistrimi i studentëve sipas programeve apo viteve të studimit.
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave të cekura më lartë, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim dhe rilicencim të BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të vendimit të parashtruar nga zv. sekretarja e MASHTI, lidhur me RISHQYRTIMIN e lëndës së kolegjit “Pjetër Budi”, vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk i plotëson kushtet për licencim, sepse i njëjti institucion për të njëjtin objekt/hapësirë është licencuar për “**Ushtrimin e veprimtarisë aftësuese për nivelin II (dy), III(tre) dhe IV(katër) sipas KKK për programet**” sipas pikave 1.1; 1.2; 1.3.

Vendimi për licencimin e kolegjit “Pjetër Budi “ mban ref. nr. 3-598 i datës 13 prill 2021. Sipas këtij vendimi, në këtë institucion ushtrohet veprimtaria në përputhje me Certifikatën e lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, konkretisht Vendimi nr. 01-326 datë 31.05.2019.

Gjithashtu, BPrAL- kolegj "Pjetër Budi" përmes Letërkonfirmimit nr. 83/2021 datë 04.03.2021 i drejtohet Ministrisë së Arsimit duke konfirmuar se ofron katin e II dhe III në shërbim të shkollës profesionale "Teknologji Informative dhe Komunikim".

Komisioni për Licencimin e BPrAL-ve, duke pasur para vetes planin e evakuimit (B+P+2) mbi bazën e së cilës hapësirë (e vënë në dispozicion) është licencuar për arsimin e mesëm të lartë profesional kati I dhe II, konstaton se nuk ka hapësirë të mjaftueshme që i mbetet në dispozicion për veprimtarinë e arsimit të lartë, si pjesën e studentëve për mbajtje të ligjëratave, ushtrimeve, konsultimeve dhe aktiviteteve të lira vepruese për ta.

Përveç tjerash, komisioni rithekson se kolegj nuk ka respektuar afatin për të bërë kërkesën me kohë për licencim për vitin 2021/2022.

Kolegj "Pjetër Budi" nuk ka asnjë të drejtë të veprave lidhur me regjistrimin, transferin e studentëve për asnjë vit akademik apo program studimi nga marrja e këtij vendimi.

Komisioni duke marrë parasysh faktet e lartcekura, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të parashtojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, Sekretarit të përgjithshëm të MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Arkivit të MASHTI;
2. Parashtruesit të kërkesës;
3. Komisionit për licencim;
4. Sekretarit të përgjithshëm, MASHTI;
5. DALSHT;
6. DNJBIA;
7. Inspektoratit, MASHTI.

Kryetar i Komisionit

Burim Gashi

